



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:089355

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06202037

PKR.nr.306/2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Gëzim Ademi, me anëtarët e trupit gjykues - gjyqtarët: Gazmend Bahtiri dhe Alltn Murseli, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, çështjen penale të të pandehurit I.S., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25) dhe i pandehuri F.K., për shkak të veprës penale Ndhimë në Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25), sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.699-2/2010 të datës 31.01.2011, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datën 26.07.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit A. H, të pandehurit I.S. me mbrojtësen e tij sipas autorizimit av. H.M., i pandehuri F.K. me mbrojtësen sipas autorizimit av. S. G. Trupi gjykues pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës e ka ri-kualifikuar veprën penale si nën pikën I të aktakuzës, nga vepra penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25) në veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës më tutje shkurtesa KPK-së, (UNMIK/RREG/2003/25), më datë 29.07.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 24.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

- I. I.S., i ati Sh. dhe e ëma S., e vajzërisë M., i lindur me datë ... në fshatin K. K. e G., ku edhe tani jeton, me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, fermer, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I

Sepse:

Me datë 05.11.2010 rreth orës 17:20 në D., në lokalim "A. C.", me dashje që ta privoj nga jeta të pandehurin-të dëmtuarin N. R., pas një mosmarrëveshje në mes të pandehurve I.S. dhe F.K. në njërën anë dhe të pandehurve N. R. dhe E. Sh. në anën tjetër, i pandehuri I.S. ka nxjerrë armën revolen e markës Zastava, cal. 6.35mm, me numër serik ... dhe ka gjuajtur në drejtim të pandehurit N. R., ku e ka goditur në zonën e nën shpatullës së majtë të shpinës, në nivel të unazës së VI (gjashtë) të shtyllës kurrizore në zonën e kafazit të kraharorit, ku ende i ka mbetur predha dhe me këtë rast i ka shkaktuar dëmtime të lehta trupore.

Me këtë ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës më tutje shkurtesa KPK-së, (UNMIK/RREG/2003/25).

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 3, 6, 11, 15, 20, 34, 36, 38, 64, 65, 66, 67, 73, dhe nenit 146 të KPK-së, e lidhur me nenet 358, 359, 364, 365, 449 dhe 462 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Të akuzuarit I.S. për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146, lidhur me nenin 20 të KPK-së, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 73 të KPK-së, të akuzuarit, koha e kaluar në paraburgim nga data 06.11.2010 deri me 06.12.2010 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës dhe atë për paushallin gjyqësor shumë prej 100 (njëqind) Euro, për programin për kompensimin e viktimave shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Kundër të akuzuarit:

II. F.K., i ati B. dhe e ëma V., e vajzërisë K., i lindur me datë ... në fshatin K., K. e G., ku edhe tani jeton, me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par 1 nën par 1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKUZA

II

Sepse;

Me të njëjtën ditë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë, i pandehuri F.K. me dashje që ti ndihmojë të pandehurin I.S. në kryerjen e veprës penale fillimisht nga mbrapa e ka goditur me boksë në regjionin e qafës të pandehurin-të dëmtuarin N. R., i cili nga goditja e marrë është ra për dysheme.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Ndhimë në Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së.

Sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.699-2/2010 të datës 31.01.2011, ndaj të akuzuarve I.S., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë

nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25) dhe i pandehuri F.K., për shkak të veprës penale Ndhimë në Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25).

Gjykata e Qarkut në Prishtinë në seancën e konfirmimit të aktakuzës të datës 14.06.2011, pas mbajtjes së seancës, të akuzuarve I.S. dhe F.K. iu është konfirmuar aktakuza PPQ në Prishtinë të datës 28.01.2011, me Aktvendimin KA.nr.83/11 të datës 14.06.2011.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, me Aktvendimin PKR.nr.306/11 e datës 01.03.2019, ka Hedhur pjesërisht Aktakuzën e Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.699-2/2010 të datës 31.01.2011 si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit I.S. për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 2 të KPK-së, pasi që është Amnistuar sipas Ligjit nr.04/L-209, të njëjtën kohë ka konfiskuar armën – revolen e markës “Zastava” cal.6.35mm, me numër serik Me të njëjtin Aktvendim PKR.nr.306/11 të datës 01.03.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, ndaj të akuzuarve N. R. dhe E. Sh., ka Hedhur Aktakuzën PP.nr.699-2/2010 të datës 31.01.2011, dhe ka pushuar procedurën penale sepse është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale me datën 05.11.2016 për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 2 lidhur me par 1 nën par 4 dhe lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa ka vazhduar procedura penale ndaj të akuzuarit I.S., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25) dhe i akuzuari F.K., për shkak të veprës penale Ndhimë në Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 25 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25).

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.06.2024, të akuzuarit kanë mbetur pranë deklaramit të tyre duke mos e pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, nën këto rrethana Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancat për shqyrtimin gjyqësor të kësaj lënde, duke filluar me fjalën hyrëse të palëve, paraqitjen e provave dhe administrimin e tyre dhe fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare:

Prokurori i Shtetit në seancën e datës 26.07.2024, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Gjatë shqyrtimit gjyqësorë lidhur me aktakuzën e ngritur nga ish prokuroria e Qarkut tani ne

Departamenti për krime te rënd ne Prishtine, PP.699-2/2010 e datës 28.01.2011, nga provat e paraqitura dhe nga dëshmia e dëshmitarit N. R. i cili po ashtu ka cilësinë e te dëmtuarit e cili me rastin e kryerjes se veprës penale ka pësuar lëndime trupore e qe fatmirësisht jo me pasoja fatale, e cila është kryer me armë zjarri, e cila është konfiskuar e po ashtu i akuzuari F. thellësisht duke kontribuar, i cili ka përdor grushtet për ta sulmua N. R. dhe E. Sh. duke i dhënë mundësi te akuzuari I. qe nxjerr dhe shtënë me armë ne drejtim te N., dhe me këtë janë plotësua elementet e veprës penale te cilën ngarkohen dhe mënyra se si është kryer kjo vepër, në publik në një lokal ne Drenas dhe me këtë ka rreziku edhe persona te tjerë e kane qene ne lokal, ndaj i propozoj gjykatës qe duke u bazua ne këto prova te njëjtit ti shpall fajtor, përveç rrethanave rëndësuese te ketë parasysh se rrethane lehtësuese se prej kryerjes se veprës penale ka kalua një kohe e gjatë e po ashtu edhe marrëdhëniet në mes të familjes te dëmtuarit dhe te akuzuarve tani nuk janë te këqija se tani sipas traditave janë pajtuar.

Mbrojtësi e të akuzuarit I.S. av. H. M., në seancën e datës 26.07.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Derisa përshkruaji gjenden faktike për një akuzë e cila ka mbi 12 vite dhe e përpiluar nga një Prokuror sidomos ne rrethana pas shkrepjes se armës nuk ka pasoja fatale por vetëm lëndime te lehta trupore siç bazohet ne ekspertize, prandaj e lus trupin gjykues qe te vlerësojë këto fakte ne kuptim te nenin 256 te KPPRK-se dhe nenin 359 par 2 te KPPRK-se, me qene se deklaratat janë dhënë ne faza te me hershme, u lexuan dhe administruan si prove, sidomos dëshmia e dëshmitarit M. Q., rreshti i parafundit i deklaratës se dhënë me datë 05.09.2010, ku citoj “ N. R. fillimisht e ka goditur me diçka prapa shpine qe mbante ne dore N., por nuk e kam pare mire se çka ka pas ne dore, kurse pastaj I. e ka nxjerrë një revole te vogël ngjyre te bronz, te tipit 6-qe, ju ka afrua personit N. R. e kam pare dhe dëgjuar kur ka shkrepur një here me armë”. Kjo dëshmi dhe dëshmia e vëllait te N. R. dhënë ne Polici i cili përshkruan se I.S. ka shtënë ne drejtim te shankut...” dhe me vone kam pa se vëllai im ka qene i përgjakur, këto dy dëshmi provojnë se i dëmtuari ka nis sherrin ka shkaktuar sulmin i pari dhe si rezultat i këtij sulmi ne afërsi te ngushtë ka shtënë i mbrojturi im duke mos e rrezikuar askënd tjetër, e cila është e kundërta e akuzës dhe cilësimit juridik sipas ish Kodit te Përkohshëm te Kosovës, dhe me qe rast lëndimet janë te natyrës se lehte me pasoja te përkohshme qe koherojnë me veprën penale lëndim i lehtë trupor me nenin 153 analog me nenin 185 par 1 nen par 1.4 te KPRK-së. Rrethanat lehtësuese te cilat janë ne favor te mbrojturi tim, jo vetëm qe kjo ngjarje ka ndodhur mbi 15 vite, lidhja e paqes ne mes te familjes R. dhe S., pasoja e rëndësisë se vogël e lusim trupin gjykues qe konform nenit 359 par 2 te ndryshoj kualifikimin juridik dhe te vënë në barrë veprën penale

Lëndim i lehët trupor e që si e tillë është parashkruar, si është parashkrua pika e dytë e akuzës me Ligjin për Amnisti, e lusim trupin gjykues ta liroj nga akuza për këtë veprë penale.

I akuzuari I.S. në seancën e datës 26.07.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtës tim dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësja e të akuzuarit F.K. av. S. G., në seancën e datës 26.07.2024, fjalën përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim në të cilën ka theksuar se: kjo aktakuzë nuk ka arritur provohet as pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor ndaj të mbrojturit tim për veprën penale për të cilën akuzohet. Siç kam theksuar në fillim të shqyrtimit gjyqësor se parimi i përgjegjësisë penale nullum poena sine culpa që nënkupton se përgjegjësinë individuale dhe se personi mund të shpallet fajtor vetëm pasi që Gjykata të konstatoj se personi ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm e jo nëse dikush është gjetur në vendin dhe rrethanat e caktuara që në ligjin penal janë paraparë si vepra penale. Mbrojtja thekson se me asnjë provë Prokuroria nuk ka arritur të dëshmoj se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, se nuk janë plotësuar asnjë nga elementet e veprës penale. Ligjdhënësi në nenin 25 të KPK ka paraparë që ndihma nënkupton ndihmën për të kryer një veprë penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fshehë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale, andaj, Gjykatë cila nga këto elemente është plotësuar në rastin konkret tek i mbrojturi im. Nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktakuzës në raport me të mbrojturin tim del se janë plotësuar elementet e veprës penale siç është vepra penale pjesëmarrje në rrahje. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, mbrojtja konsideron se Prokuroria nuk ka arritur që të argumentoj fajësinë e të mbrojturit tim, meqë pafajësia e tij presumohet, nuk ka arritur në mënyrë të sigurt dhe të pakontestueshme ta argumentoj fajësinë e të akuzuarit.

I akuzuari F.K. në seancën e datës 26.07.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtës tim dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

Provat e administruara:

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje

dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar dëshmitarët N. R. dhe L. S. si dhe ka lexuar deklaratën e dëshmitarit M. Q. e dhënë në Polici më datë 05.09.20210, po ashtu ka administruar provat material: Vërtetimi mbi konfiskimin e armës i datës 05.11.2010, ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore për të pandehurin N. R. e datës 01.12.2010 dhe ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore për të pandehurin F.K. e datës 13.12.2010, njëkosishtë i propozoj gjykatës që revolja e sekuestruar të konfiskohet, ku mbrojtja nuk i ka pas vërejtje për këto prova, ashtu që Gjykata mbi bazën e këtyre provave, pas vlerësimit të tyre ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deklarimet e dëshmitarëve:

Lidhur me këtë çështje penalo-juridike, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësinë e dëshmitarit të propozuar nga Prokuroria e Shtetit dëshmitar N.R. si dhe dëshmitarin L. S. si dhe ka lexuar deklaratën e dëshmitarit M. Q. e dhënë në Polici më datë 05.09.20210.

Në seancën shqyrtimit gjyqësor të datës 31.05.2024, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin N. R. i cili ka deklaruar se: Kemi qenë në një kafiteri “A. C.”, kam qenë duke pirë kafe me E. Sh. në një tavolinë, unë nuk i kam parë fare në tavolinë ku kanë qenë ulur të pandehurit, ngase kam qenë me shpinë nga tavolina e tyre, pa e ditur unë fare se i kam këta mbrapa, fillimisht më kanë goditur, me grushte ose me shishe qelqi nuk e di saktë, kur jam ngritur në këmbë, i pandehuri I.S. më ka gjuajtur me revole dhe më ka plagosur në shpinë nga krahu i majtë dhe plumbi më ka mbetur në trup. Pastaj, në ato momente kur më ka plagosur, unë kam gjuajtur në drejtim të tyre me shishe qelqi, kanë ardhur njerëzit, kanë hyrë ndërmjet, i pandehuri ka shtënë në drejtim timin edhe 2 – 3 herë, mirëpo mua nuk më kanë goditur, por plumbat kanë qenë në drejtim timin, ka ekzistuar një stub-shtyllë betoni në kafe, unë kam qenë afër stubit dhe gjuajtjet kanë qenë në drejtimin timin dhe disa plumba janë gjetur në stub dhe banak të kafes. Të njëjtit kanë dalë nga lokali, njerëzit që kanë qenë në kafe më kanë kapur mua të më japin ndihmë, më kanë dërguar në Ambulantë në D., e pastaj në QKUK në Prishtinë, më kanë dhënë ndihmën e parë, pasi që i kam përfunduar kontrollet, po atë natë më kanë lëshuar spitali dhe më kanë thënë se duhet t’i bëj kontrollet vazhdimisht, kam vazhduar kontrolle të vazhdueshme. Fillimisht, F.

më ka goditur një herë në shpinë, para se të shtie me armë I. në drejtim timin. Në kafe ka pasur diku rreth 200 persona dhe të gjitha gjuajtjet nga i pandehuri I.S. kanë qenë në drejtim timin, por vetëm një plumb më ka goditur mua. Nga vendi ku ka gjuajtur në drejtim timin, distanca ka qenë diku 6 metra nga i pandehuri në raport me mua. Fillimisht I. më ka gjuajtur një herë ku më ka goditur, pastaj unë e kam gjuajtur me shishe qelqi, ai ka filluar prapë të shtënë në drejtimin tim një nga një dhe duke u larguar. Në atë rast, të dy kanë dal nga lokali. I pandehuri I.S. më ka vrarë dhe gjuajtjet kanë qenë me qëllim për të më vrarë, mirëpo Zoti nuk më ka vrarë. Të pandehurit më herët i kam njohur dhe mosmarrëveshja ka ardhur në lokalin tim, dy javë para ngjarjes kritike, sepse të njëjtit vinin në lokalin e vëllait, ku punoj unë dhe bënin probleme me njerëz, andaj të njëjtëve iu kam thënë të mos vijnë më në lokal, sepse bënin probleme dhe po largohen njerëzit nga lokali. Është e vërtetë se kam gjuajtur me shishe qelqi dhe me vonë e kam kuptuar se e kisha goditur F. N. R. ka qenë larg në një tavolinë tjetër i ulur dhe M. Q. ka qenë ulur në një tavolinë tjetër, diku një tavolinë afër tavolinës tonë, ketë nuk kanë qenë së bashku ulur në tavolinë. Të pandehurit I. i kam thënë që mos të vij në kafe se po mi largon klientët sepse po bënin probleme. Të pandehurin F. e kam njohur edhe me herët dhe ka ardhur edhe me herët në kafe por që nuk kam pas asnjë problem me atë, unë nuk e kam parë që i pandehuri F. më ka goditur por që më vonë nga njerëzit e kam kuptuar se F. me ka goditur në shpinë. Në tavolinë me mua ka qenë E. Sh. si dhe ka pas njerëz në lokal, të pandehurit fillimisht e kanë bërë pagesën e pastaj kanë ardhur kah unë duke dal nga lokali dhe me kanë goditur në shpinë, pastaj jam ngritur në këmbë kam gjuajtur me shishe qelqi, e ata gjuanin me armë, të shtënat kanë qenë në drejtim timin, momenti ka qenë se, më ka goditur në shpinë, unë jam përulur, pastaj jam ngrit në këmbë dhe në ato momente i akuzuari I. me ka goditur një herë, i njëjti ka shtënë në drejtim timin, unë pastaj kam gjuajtur me shishe në drejtim të tyre.

Tani jemi pajtuar në mes veti, nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk paraqes kërkesën pasurore juridike.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësore të datës 26.07.2024, gjykata ka dëgjuar dëshmitarin L. S., i cili ka deklaruar se: Unë fillimisht jam arrestuar si i dyshuar, pastaj unë i kam propozuar në Polici dy dëshmitar, njeri ka qenë Polic Gj. B. kurse tjetri ka qenë I. G., aty nga Policia e kam kuptuar rastin që ka ndodhur ngase nuk kam qenë njohuri fare, largësia në mes meje ku kam qenë në ditën kritike dhe vendit ku ka ndodhur ngjarja ka qenë 10 km ngase në ditën kritike kam qenë në K. kur ka ndodh rasti ndërsa rasti ka ndodhur në D. N. e kam njohur kurse E. nuk e kam njohur. Problemi nuk kemi pasur me këta dy persona me pare. Nuk e di perse ka ardhur ai problem por dua të shtoj se në vitin 2019 në lokalin tim ka ardhur vëllai i N., B. R. së bashku me një shok te

përbashkët tonin B. A, dhe aty me ka treguar se N. e ka nisur sherrin dhe ai është fajtor, unë nuk kam qenë prezent ne ditën kritik mirëpo vëllai i N. R. me ka thënë se N. e ka gjuajtur me shishe. Nuk e di arsyen pse, N. kurrë nuk na ka thënë se mos hajde ne lokalin tim për arsye se kurrë nuk kemi qene në lokalin e tij. Ne me familjen e R. jemi pajtuar mes veti, vëllai i tij ka ardhur ne lokalin tonë ne mënyre shoqërore.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.07.2024, është lexuar deklarata e dëshmitarit M. Q. të dhënë në Polici me datë 05.09.2010 pasi që nga raportet policore, Gjykata është njoftuar se dëshmitari gjendet jashtë shtetit përkatësisht ne Austri, sipas propozimit nga Prokurori i Shtetit i cili propozim nuk është kundërshtuar nga mbrojtja dhe të pandehurit, gjykata ka lexuar dhe ka administruar si provë deklaratën e dëshmitarit M. Q. dhënë në Polici me datën 05.09.2010, e që në këtë deklaratë thuhet se: sot me datën 05.11.2010 rreth orës 17:00 kam qenë duke pirë kafe në lokalin “A. C.” në D. së bashku me R. G. nga G. Unë isha i ulur ne një tavolinë afër shankit. Në një tavolinë tjetër në fund të lokalit afër xhamave kanë qenë ulur I.S., L. S. dhe një person tjetër nga K. të cilit emrin nuk ja di por e di që është vëllai i F. Derisa isha duke pirë kafe, kam vërejtur personin qe ishte me I. S. i cili bashkë me I. S. janë afruar te tavolina e N. R. dhe ky person fillimisht e ka goditur prapa shpinës me diçka që mbante ne duar N., por nuk e kam parë mirë se çfarë ka pasur në duar, kurse pastaj I. e ka nxjerrë një revole të vogël ngjyrë të bronzte e tipit 6-qe dhe iu ka afrua personit N. R. dhe papa shpinës se tij kam pare dhe dëgjuar qe ka shtënë një herë me armë në drejtim të N. dhe e ka goditur në shpinë. N. ka qenë i ulur në tavolinë me E. Sh. nga P. i R. Me pastaj, pasi ka gjuajtur një herë me armë I., unë kam vërejtur edhe L. S. që mbante armë në duar po ashtu të tipi 6-qe, ku L. ka gjuajtur dy herë me armën e tij në drejtim të E. Sh. por nuk e ka goditur. Me pastaj, të gjithë njerëzit janë ngritur në këmbë për të ikur.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësore të datës 26.07.2024, është tërhequr nga dëgjimi i dëshmitarit N. R. pasi që i njëjti është i pa arritshëm për organet e drejtësisë, propozim që nuk është kundërshtuar nga mbrojtja dhe të pandehurit.

Pas dëgjimit dhe administrimit të provave personale të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit dhe dëshmitarëve të tjerë, gjykata ka vazhduar me administrimin e provave materiale si: Vërtetimi mbi konfiskimin e armës i datës 05.11.2010, ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore për të pandehurin N. R. e datës 01.12.2010 dhe ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore për të pandehurin F.K. e datës 13.12.2010, njëkohësisht i propozoj gjykatës qe revolja e sekuestruar te konfiskohet.

Nga raporti i oficerit M. M. KPS#... të datës 05.11.2010, gjykata ka vërtetuar se të pandehurit I. S. dhe F.K. me datën 06.11.2010 rreth orës 13:30 janë dorëzuar në Stacionin Policor në D., po ashtu i pandehuri I.S. ka dorëzuar armën e tipit “Zastava” Cal.6.35mm me numër serik ..., në karikator dhe një fishek të të njëjtit kalibër të cilën Policia e ka konfiskuar si dëshmi materiale.

Nga ekspertiza e ekspertit Dr. T. G. të mjekësisë ligjore për të pandehurin N. R. e datës 01.12.2010, gjykata ka konstatuar se i pandehuri ka pësuar lëndime të lehta trupore në kufirin e sipër të tyre si një plagë shkuese nga arma e zjarrit në zonën e nën shpatullës së majtë në për rrethinë të shtyllës kurrizore, në nivel të unazës së VI torakale të kafazit të kraharorit, kjo plagë ka ardhur si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hudhur nga arma e zjarrit, plaga shkuese nga arma e zjarrit me kanalin e saj ka përfshi: lëkurën dhe indet nën lëkurore në zonën paravertebrale të majtë të shpinës, në nivel të unazës së VI të shtyllës kurrizore, në zonën e kafazit të kraharorit ku edhe ka ngelur në muskujt paraspinal dorsal të saj. Ky dëmtim trupor në bazë të dokumentimit mjekësor të prezantuar, nuk ka lënë pasojë të përhershme për të dëmtuarin.

Nga ekspertiza e ekspertit Dr. T. G. të mjekësisë ligjore për të pandehurin F.K. e datës 13.12.2010, gjykata ka konstatuar se i pandehuri ka pësuar lëndime të lehta trupore si një plagë e pasojës së veprimit të mjetit të fort dhe të furishëm mekanik mbretes të topitur, plagë mbetëse - shqyese në zonën e mbivetullës së majtë për të cilën nuk është përshkruar lokalizimi i saktë, madhësia, forma etj. Ky dëmtim në kanalin e tij ka përfshirë lëkurën dhe indet nën lëkurore të zonës së mbivetullës së majtë, nuk ka lënë pasojë të përhershme për shëndetin e të dëmtuarit.

Mbrojtja e të pandehurve:

I pandehuri I.S., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.07.2024, është mbrojtur në heshtje por që ka mbetur pranë deklaratave të dhëna me herët në Polici dhe Prokurori. I pandehuri I.S. në Prokurorin Publike të Qarkut në Prishtinë me datë 19.11.2010 ka deklaruar se: Ishte dite e premtë, kam qenë në kafiteri “A. C.” në D. me F. K., jemi ulur dhe kemi porositur pije, në ato momente me ka telefonuar babai im dhe kam dal jashtë lokalit për të folur në telefon dhe kur kam hy brenda kishin qenë duke e rrah bashkëfshatarin tim F. personat N. R., E. Sh., M. Q. dhe N. R., në ato momente kam vërejtur se N. R. kishte pas thikë dhe E. ndërsa M. Q. një shufër metalike dhe N. R. shufër gome, kishin qenë duke e rrah F. dhe unë kur kam vërejtur se ishin duke e rrah i cili ishte i përgjakur me qëllim të frikësimit të tyre që të mos vazhdon rrahja, më vete e kisha revolen dhe me qëllim frikësimit ju kam drejtuar të njëjtëve që ta lëshojnë F. dhe

kur kam vërejtur se ata nuk po e lëshojnë por po vazhdojnë ta rrahin, unë kam gjuajtur një herë në muri dhe një herë drejtim të dyshemesë, ata nga frika e kanë lëshuar dhe e kam kapur F. dhe kemi ikur. Si është plagosur N. nuk e di, se unë kam gjuajtur në drejtim të dyshemesë, pastaj me F. së bashku jemi larguar nga lokali, e kam paguar një taksi dhe e kam dërguar në fshatin K. Nuk e përjashtoj mundësinë që ajo plagosje ka qenë nga arma ime por unë kam gjuajtur në drejtim të dyshemesë por ka qenë plumb bredhës dhe e ka goditur të dëmtuarin por në rrezik për jetë ka qenë F. pasi ata e kanë sulmuar dhe me qëllim të evitimit më të keqes kam qenë i detyruar me qëllim të frikësimit. Po qese dëshiroja të privoja nga jeta, unë kam pasur municion të mjaftueshëm dhe në afërsi rreth 2 metra shumë të afërt por nuk kam dashur që ta privoj nga jeta por qëllimi ka qenë vetëm frikësimi. Tani jemi pajtuar me familjen e të dëmtuarit dhe njihemi familjarisht dhe nuk kemi pas asnjë të keqe. Kur kam tentuar ta tërheq F., me kanë gjuajtur me shishe nga qelqi dhe me kanë goditur në gjoks dhe shpinë dhe pikërisht më ka gjuajtur E. Sh.

I pandehuri F.K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.07.2024, është mbrojtur në heshtje por që ka mbetur pranë deklaratave të dhëna me herët në Polici dhe Prokurori. I pandehuri F.K. në Prokurorin Publike të Qarkut në Prishtinë me datë 02.12.2010 ka deklaruar se: rreth orës 17:00 kam qenë së bashku me I. S. në lokalin “A. C.” në D. nuk më kujtohet data, kemi hyrë dhe jemi ulur në një tavolinë afër banakut, në atë lokal kanë qenë ulur një tavolinë më larg vëllai i N. R., N, në ndërkohë e kam vërejtur se e ka thirr dikën në telefon dhe pas një kohe ka ardhur N. R., E. Sh. dhe një person nuk e njoh dhe janë ulur në një tavolinë afër neve. Derisa I. ka qenë duke fol në telefon jashtë lokalit, ka ardhur N. te tavolina ime dhe me ka thënë “ a të kam thënë ti mos me dal në D. më” dhe kur është afruar afër tavolinës e ka nxjerr një thikë me dorezë dhe tek diku 20 cm, unë i thashë “ngadalë a mundemi me u marr veshë me fjalë” dhe ai më ka ra mbi vetullën e majtë dhe ka filluar të më rrjedhë gjaku dhe jam rrezuar në dysheme, menjëherë kam dëgjuar dy krisma të armës, krismën e parë nuk e vërejtur por në krismën e dytë ata më kanë lëshuar dhe unë e kam pa I. me armë në dorë, me ka kap për krahu me ka qit jashtë, pastaj më kanë dërguar në spital. Kur me ka goditur me thikë N., E. ka pas thikën në dorë të cilën e ka mbajtur në brez por me teh kah dyshemeja dhe M. ka qenë pas tyre por nuk e di çka ka pas në dorë, E.me ka goditur me shkelm në anën e djathtë nën sqetull pasi që jam rrëzuar në dysheme. I. ka pas një revole të tipit 6-qe dhe ka shkrepur dy herë, motivi i kësaj ngatërrese ka qenë se 3-4 ditë më herët N., E. dhe M., më kanë ndalur dhe më kanë thënë “mos të shohim më në D.” por që arsyen nuk e di. Nuk kemi pas ndonjë mosmarrëveshje të më hershme, tani jemi pajtuar me familjen e N.

Vlerësimet e Gjykatës për piken I të këtij aktgjykimi për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së:

Faktet jo kontestuese:

Gjykata, pasi ka dëgjuar të gjithë dëshmitarët në këtë rast, provat materiale, mbrojtjen e të pandehurve, pretendimet e palëve, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nuk është kontestues fakti se në lokalin “A. C.” në D., me datë 05.11.2010 rreth orës 17:20 kishte shtënë me armë i pandehuri I.S. në drejtim të dëmtuarit N. R.

Nuk është kontestuese fakti se i pandehuri I. kishte pas me vete armën e tipit Zastava, cal 6.35mm me numër serik ..., të cilën edhe e ka dorëzuar ditën e dorëzimit të tij me datë 06.11.2010 rreth orës 13:30 në Stacioni Policor në D., e cila armë është konfiskuar në Policia po të njëjtën ditë.

Nuk është kontestuese fakti se të pandehurit I. dhe F. kishin qenë ditën kritike në lokalin “A. C.” në D., po ashtu edhe të pandehurit-dëmtuarit tjerë si N. R., E. Sh. dhe M. Q.

Nuk është kontestuese fakti se lëndime të lehta trupore i pandehuri-dëmtuari N. R. kishte pësuar nga arma e zjarrit siç është konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore, me të cilën kishte shtënë i pandehuri I.S..

Nuk është kontestuese fakti se i pandehuri F.K. kishte pësuar lëndime të lehta trupore nga mjeti të fort dhe të furishëm mekanik mbretes.

Për palët, gjendja faktike si më lartë nuk ka qenë kontestuese. Përveç kësaj, faktet si më lartë vërtetohen edhe nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Faktet kontestuese:

Fakt kontestues për palët si dhe për Gjykatën ishte, nëse i pandehuri I.S. kishte shtënë me dashje dhe qëllim që ta privonte nga jeta tani të dëmtuarin N. R.?

Gjendja faktike dhe vlerësimi i provave:

Gjykata në kuptim të nenit 361 paragrafi 2 të KPPRK-së, me ndërgjegje ka administruar dhe vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha në lirshmëri njëra me tjetrën, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri I.S. me datë 05.11.2010, rreth orës 17:20, në lokalin “A. C.” në D., i pandehuri I.S. me dashje që ta privoj nga jeta të pandehurin-dëmtuarin N. R., pas një mosmarrëveshje në mes të pandehurve I.S. dhe F.K. në njërën anë dhe të pandehurve N. R. dhe E. Sh., ku i pandehuri I. ka nxjerrë revolen e markës Zastave cal.6.35 mm me numër serik ... dhe ka shtënë në drejtim të dëmtuarit N., ku e ka goditur në zonën e nën shpatullës së majtë të shpinës, në nivel të unazës VI (gjashtë) të shtyllës kurrizore e kafazit të kraharorit, ku ende i ka mbetur predha dhe me këtë rast i ka shkaktuar dëmtime të lehta trupore.

Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushën elementet e veprës penale të Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën parë 4 lidhur më nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25), pasi që nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale për të cilën akuzohet, sepse për të ekzistuar kjo vepër penale duhet të përmbushen elementet e veprës penale si: “Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave”, pra janë këto elemente të kësaj vepre penale, të cilat nuk janë përmbushur sepse Prokurori i Shtetit në asnjë rrethanë nuk e ka provuar faktin se ka vënë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave, duke mos ofruar asnjë provë apo fakt tjetër se cilët janë ata persona, sa persona kanë qenë në lokal, cila ka qenë afërsia e atyre personave me rastin e shtënies së armës nga i pandehuri I., andaj, në mungesë të provave si dhe fakteve të tjera, Gjykata nuk ka mund të vërtetojë faktin se veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën parë 4 lidhur më nenin 20 të KPK-së.

Rikualifikimi i veprës penale:

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, sipas aktakuzës PP.nr.699-2/2010 të datës 31.01.2011, të pandehurin I.S. e ka akuzuar për veprën penale: Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën parë 4 lidhur më nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25).

Gjykata, pasi që i ka vlerësuar pretendimet e Prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë deponuar, provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, të gjitha këto nga gjykata janë vlerësuar në raport me nenin 359 të KPPRK-ës. Gjykata nuk detyrohet me propozimet e Prokurorit të Shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale. Kjo sipas nenit (359 par.2 të KPPRK-se).

Gjykata, në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike, në raport me veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën parë 4 lidhur me nenin 20 të KPK-së, gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të të gjitha provave në këtë çështje penale dhe për arsye se nuk është provuar përshkrimi në aktakuzë që prokuroria ka bërë. Gjykata, në përshkrimin faktik nuk ka ndryshuar identitetin subjektiv të veprës penale, nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me vendin, të pandehurin, përveç se ka ndryshuar rrethanat cilat i ka provuar në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e ka përshkruar gjendjen faktike ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor. Gjendja faktike e përshkruar në akuzë në raport me të akuzuarin, ka rezultuar me një kualifikim tjetër ligjor. Mbi bazën e provave gjykata në këtë aktgjykim ka dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt të vërtetuar. Sipas vlerësimit të gjykatës kjo situatë është e rregulluar me nenin 359 par.2 dhe 360 të KPPRK-ës.

Gjykata duke u mbështetur në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtimin gjyqësor të cilat i ka vlerësuar me ndërgjegje një nga një dhe në lidhshmëri të të gjitha provave ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mire se janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale Vrasje nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së. Andaj Gjykata për këtë veprë penale të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata duke u bazuar në dispozitën e neni 359 të KPPRK-ës, e cila dispozitë nuk e detyron gjykatën me propozimin e prokurorisë lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale, në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike në masën e lejueshme, për faktin se gjendja faktike në një rast drejtpërdrejt e determinon kualifikimin juridike të veprës penale.

Vlerësimi ligjo i veprës penale:

Gjykata vë në vëmendje se vepra penale Vrasje nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, është parashikuar forma e veprës penale, sipas së cilës dispozitë këtë veprë penale e kryen *“Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me së paku pesë vjet burgim”*.

Gjykata gjen se në veprimet e të pandehurit I. përmbushen të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale të Vrasje nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, këtë gjendje faktike Gjykata e ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, nga provat që ka administruar në shqyrtim gjyqësor si nga dëshmia e dëmtuarit N. R. cili ka deklaruar se fillimisht më kanë goditur, me grushte ose me shishe qelqi nuk e di saktë, kur jam ngritur në këmbë, i pandehuri I.S. më ka gjuajtur me revole dhe më ka plagosur në shpinë nga krahu i

majtë dhe plumbi më ka mbetur në trup, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar edhe nga prova materiale e ekspertizës mjeko-ligjore për të dëmtuarin N. i cila ekspertizë ka konstatuar se ka pësuar lëndime të lehta trupore në kufirin e sipër të tyre si një plagë shkuese nga arma e zjarrit në zonën e nën shpatullës së majtë në për rrethinë të shtyllës kurrizore, në nivel të unazës së VI torakale të kafazit të kraharorit, kjo plagë ka ardhur si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hudhur nga arma e zjarrit, plaga shkuese nga arma e zjarrit, po ashtu pjesërisht edhe nga deklarimi i të pandehurit I., i cili në Prokurori kishte deklaruar se ka shtënë më armë dy herë.

Gjykata ka vlerësuar këto dëshmi së dëshmi reale, të bazuara, koherente dhe objektive sepse dëshmia e dëshmitarit N., është në lidhshmëri edhe me provën materiale të ekspertizës mjeko-ligjore dhe pjesërisht edhe me deklarin e të pandehuri I., andaj Gjykata këtyre dëshmimeve ju ka falur besimin si provë personale dhe materiale në të cilin dhe e bazon aktgjykimin.

Se ishte i pandehuri I.S. personi që kishte shtënë me armën e tipi Zastava cal 6.35mm me numër serik ..., vërtetohet edhe me provën materiale nga raporti i oficerit M. M. KPS#... të datës 05.11.2010, ku vërtetohet fakti se i pandehuri I. S. me datën 06.11.2010 rreth orës 13:30 është dorëzuar në Stacionin Policor në D., po ashtu i pandehuri I.S. ka dorëzuar armën e tipit “Zastava” Cal.6.35mm me numër serik ..., në karikator dhe një fishek të të njëjtit kalibër të cilën Policia e ka konfiskuar si dëshmi materiale, andaj Gjykata kësaj prove i ka fal besimin e plotë.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit L. S. i dëgjuar në gjykatë, por që i njëjti ka deklaruar se ditën kritike nuk kam qenë në lokalin “A. C.” dhe se nuk e din se si është zhvilluar ngjarja përveç se çka ka kuptuar tutje nga njerëzit e tjerë, andaj Gjykata nuk i ka falur besimin kësaj dëshmie të dëshmitarit ngase përveç se nuk ka qenë ditën kritike në vend ngjarje ashtu edhe deklarin e tij nuk ishin në lidhshmëri me ngjarjen dhe provat tjera si pasojë e mungesës të informacioneve.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit M. Q., të cilën dëshmi e ka lexuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.07.20204 është lexuar deklarata e tij dhënë Polici me datën 05.09.2010 në cilësinë e dëshmitarit, në të cilin kishte deklaruar se, derisa isha duke pirë kafe, kam vërejtur personin qe ishte me I. S. i cili bashkë me I. S. janë afruar te tavolina e N. R. dhe ky person fillimisht e ka goditur prapa shpinës me diçka që mbante në duar N., por nuk e kam parë mirë se çfarë ka pasur në duar, kurse pastaj I. e ka nxjerrë një revole të vogël ngjyrë të bronzitë e tipit 6-

qe dhe iu ka afrua personit N. R. dhe papa shpinës se tij kam pare dhe dëgjuar qe ka shtënë një herë me armë në drejtim të N. dhe e ka goditur në shpinë.

Gjykata e ka vlerësuar këtë dëshmi si reale, koherente dhe objektive sepse e njëjta dëshmi është në përputhje edhe me dëshminë e dëshmitarit N. R. i cili ka deklaruar se fillimisht me kanë goditur prapa në shpinë kur unë isha ulur, pastaj kur jam ngritur ne këmbë dhe kam fillua me gjuajt me shishe qelqi atëherë i pandehuri I. ka shtënë armë në drejtimin tim dhe më ka goditur në shpinë.

Kjo dëshmi është lexuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.07.2024 pas propozimit të Prokurorit të Shtetit, i cili propozim nuk është kundërshtuar nga mbrojtja dhe se Gjykata ka vlerësuar se mund të bëhet leximi i kësaj deklarate dhe të administrohet si provë në këtë shqyrtim gjyqësor sepse dëshmitari M. Q. fillimisht është intervistuar nga Policia e Kosovës me datën 05.09.2010, e qe ne këtë deklaratë për këtë rrethanë faktike ka deklaruar se I. e ka nxjerrë një revole të vogël ngjyrë të bronzitë e tipit 6-qe dhe iu ka afrua personit N. R. dhe papa shpinës se tij kam pare dhe dëgjuar qe ka shtënë një herë me armë në drejtim të N. dhe e ka goditur në shpinë.

Dashja eventuale:

Në veprimet e të pandehurit I. dhe nga gjendja dhe rrethanat faktike të vërtetuara në shqyrtimin gjyqësor, po ashtu bazuar në dispozitën ligjore të nenit 15 të KPK-së, Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ka vepruar me dashje eventuale në kryerjen e kësaj vepra penale, ngase i pandehuri duke e ditur dhe se duke qenë i vetëdijshëm për pasojën që mundë të shkaktohet nga e shtëna me armë, i pandehuri ka shtënë me armë duke e pranuar edhe pasojën që mund të shkaktohet nga kjo e shtënë, pra vrasjen apo privimin nga jeta e të dëmtuarit N., sepse i njëjti në një afërsi prej 2 metrave ka shtënë në drejtim të dëmtuarit N. të cilin e ka goditur ne zonën e nën shpatullës së majtë të shpinës, në nivel të unazës VI (gjashtë) të shtyllës kurrizore e kafazit të kraharorit, ku ende i ka mbetur predha dhe me këtë rast i ka shkaktuar dëmtime të lehta trupore.

Tentativa:

Bazuar në dispozitën e nenit 20 të KPK-së, tentativa është “*kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale*”, dhe “*Tentativa për kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet...*” në rastin konkret penal i pandehuri I. ka vepruar me dashje eventuale, pra i njëjti ka pranuar pasojën qe mund të shkaktohet, privimin nga jeta i të dëmtuarit N. por që kjo

dashje e tij ka mbetur ne tentativë pasi që pasoja e veprimeve të tij nuk është përfunduar, nuk ka vdekur i dëmtuari N. por ka pësuar lëndime të lehta trupore nga e shtëna me armë në afërsi prej 2 metrave nga i pandehuri I. i cili duke u larguar ka shtënë edhe 2-3 here ne drejtim te dëmtuarit por qe nuk e ka goditur tutje pasi qe ne restauruan-kafe si pengesë ka qene stubi-shtylla e betonit ku ne te janë gjetur edhe plumbat qe ishin shtënë ne drejtim te dëmtuarit, më pas është larguar nga vendi i ngjarjes, e i dëmtuari është dërguar nga spital për trajtim emergjent, ndërsa i pandehuri I. është larguar nga vendi i ngjarjes duke mbetur ne tentativë vepra penale e vrasjes.

Gjykata për gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën e ka ri kualifikuar Gjykata, për këto veprime të tij, Gjykata e shpalli fajtor dhe e dënoi sipas ligjit, siç edhe konstatohet në këtë aktgjykim.

Vlerësimi i mbrojtjes:

Lidhur me pretendime e mbrojtësit të pandehuri I.S., av. H. M., se, pasojat pas shkrepjes së armës janë lëndime të lehta trupore duke i kërkuar trupit gjykues qe të bëjë rikualifikimin e veprës penale nga Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën parë 4 lidhur më nenin 20 të KPK-së, ngase në kuptim të nenit 256 dhe 359 par 2 të KPPRK-së e sidomos deklarata e dëshmitarit M. Q. rreshti i parafundit i deklaratës se dhënë me datë 05.09.2010, ku citoj “ N. R. fillimisht e ka goditur me diçka prapa shpine qe mbante ne dore N., por nuk e kam pare mire se çka ka pas ne dore, kurse pastaj I. e ka nxjerrë një revole te vogël ngjyre te bronz, te tipit 6-qe, ju ka afrua personit N. R. e kam pare dhe dëgjuar kur ka shkrepur një here me armë”, dhe me që rast lëndimet janë te natyrës se lehte me pasoja te përkohshme që koherojnë me veprën penale lëndim i lehtë trupor me nenin 153 analog me nenin 185 par 1 nen par 1.4 te KPRK-së e lusim trupin gjykues qe konform nenit 359 par 2 te ndryshoj kualifikimin juridik dhe te vënë në barrë veprën penale Lëndim i lehtë trupor e që si e tillë është parashkruar. Rrethanat lehtësuese te cilat janë ne favor te mbrojturi tim, jo vetëm qe kjo ngjarje ka ndodhur mbi 15 vite, lidhja e paqes ne mes te familjes R. dhe S., pasoja e rëndësisë se vogël, e lusim trupin gjykues ta liroj nga akuza për këtë vepër penale.

Gjykata nga gjendja faktike si dhe nga administrimi i provave ka vërtetuar, një tjetër gjendje faktike nga ajo që mbrojtësi i të pandehurit I. pretendon, ngase tek i pandehuri I. ka vërtetuar dashjen e tij eventuale për shkaktimin e pasojës duke e ditur se me veprimin e tij, pra me shtënie

me armë mund të kishte privuar nga jeta tani të dëmtuarin N. R., edhe pse pasojat janë të natyrës së lëndimeve te lehta trupore të konstatuara nga ekspertiza mjeko-ligjore, ky fakt nuk e liron dhe as nuk mund të bëhet një rikualifikim siç mbrojtja ka kërkuar sepse elementi i dashje për privim nga jeta i të dëmtuari N. R. ka ekzistuar tek i pandehuri I.S., prandaj mbi këtë fakt dhe në lidhshmëri edhe me provat tjera, pretendimet e mbrojtës janë të pa qëndrueshme në raport me veprimet e të mbrojturit të tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit I.S. e dhënë ne Polici dhe Prokurori, i cili kishte deklaruar se ditën kritike kam qenë në kafiterin “A. C.” në D. me F. K., jemi ulur dhe kemi porositur pije, në ato momente me ka telefonuar babai im dhe kam dal jashtë lokalit për të folur në telefon dhe kur kam hy brenda kishin qenë duke e rrah bashkëfshatarin tim F. personat N. R., E. Sh., M. Q. dhe N. R., në ato momente kam vërejtur se N. R. kishte pas thikë dhe E. ndërsa M. Q. një shufër metalike dhe N. R. shufër gome, kishin qenë duke e rrah F. dhe unë kur kam vërejtur se ishin duke e rrah i cili ishte i përgjakur me qëllim të frikësimit të tyre që të mos vazhdon rrahja, më vete e kisha revolen dhe me qëllim frikësimit ju kam drejtuar të njëjtëve që ta lëshojnë F. dhe kur kam vërejtur se ata nuk po e lëshojnë por po vazhdojnë ta rrahin, unë kam gjuajtur një herë në muri dhe një herë drejtim të dyshemesë, ata nga frika e kanë lëshuar dhe e kam kapur F. dhe kemi ikur. Si është plagosur N. nuk e di, se unë kam gjuajtur në drejtim të dyshemesë, pastaj me F. së bashku jemi larguar nga lokali, nuk e përjashtoj mundësinë që ajo plagosje ka qenë nga arma ime por unë kam gjuajtur në drejtim të dyshemesë por ka qenë plumb bredhës dhe e ka goditur të dëmtuarin. Po qese dëshiroja të privoja nga jeta, unë kam pasur municion të mjaftueshëm dhe në afërsi rreth 2 metra shumë të afërt por nuk kam dashur që ta privoj nga jeta por qëllimi ka qenë vetëm frikësimi.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit I.S. për të cilën ishte deklaruar në Polici dhe Prokurori pasi që në shqyrtimin gjyqësor në Gjykatë ka zgjedhur që të mbrohet në heshtje. Gjykata nuk i ka fal besimin deklaramit të tij për pjesën e deklaratës ku i pandehuri kishte deklaruar se “kam shtënë dy herë, një herë në drejtim të murit dhe një herë në drejtim të dyshemesë”, sepse nga vet deklarimi i tij në afërsi prej dy metrave i pandehuri ka shtënë në drejtim të trupit tek i dëmtuari N. dhe atë në pjesën e organeve vitale të trupit, ku të njëjtin e ka goditur në pjesën ne zonën e nën shpatullës së majtë të shpinës, në nivel të unazës VI(gjashtë) të shtyllës kurrizore e kafazit të kraharorit, ku ende i ka mbetur predha dhe me këtë rast i ka shkaktuar dëmtime të lehta trupore, fakt i cili është vërtetuar edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore për të dëmtuarin N. R., e datës 01.12.2010, ndërsa për pjesën e deklaratës se “nuk e përjashtoj

mundësinë që ajo plagosje ka qenë nga arma ime por unë kam gjuajtur në drejtim të dyshemesë por ka qenë plumb bredhës dhe e ka goditur të dëmtuarin” si dhe “Po qese dëshiroja të privoja nga jeta, unë kam pasur municion të mjaftueshëm dhe në afërsi rreth 2 metra shumë të afërt por nuk kam dashur që ta privoj nga jeta por qëllimi ka qenë vetëm frikësimi”, kjo pjesë e deklarimit të pandehurit nuk qëndron pasi që është në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar sepse Gjykata nga provat që ka administruar është vërtetuar dashja e të pandehurit për privimin nga jeta e të dëmtuarit N., sepse të shtënat me armë nga i pandehuri ishin të drejtuar në trupin e të dëmtuarit, të njëjtin e ka goditur dhe i ka shkaktuar lëndime trupore dhe prap ka vazhduar me të shtëna në drejtim të dëmtuarit, mirëpo si pengese ka qenë stubi-shtylla e betonit për ta goditur përsëri të dëmtuarin, pavarësisht asaj që lëndimet janë të natyrës së lehtë trupore, pra qëllimi i të pandehurit ishte privimi nga jeta i të dëmtuarit e jo siç pretendon i pandehuri qëllimin vetëm të frikësimit, ngase goditja me plumb në pjesën vitale të dëmtuarit nuk ka për qëllim frikësimin por ka për qëllim privimin nga jeta, duke pasur parasysh afërsinë e goditjes, mjetin të cilin e ka përdorur, ku revolva është mjet i përshtatshëm për privimin nga jeta, andaj në këto rrethana dhe nga provat e administruar në shqyrtimin gjyqësorë, gjykata nxjerr përfundimin se i pandehuri me dashje e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 64 të KPK-së, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar; shkalla e lartë të dashjes së të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, pesha dhe pasoja e shkaktuar me këtë vepër penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur si dhe e kaluarat e tij kriminale ku nga evidenca e të kaluarës kriminale rezulton se i njëjti është i dënuar për disa vepra penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese, Gjykata e ka marrë parasysh dhe vlerësuar si të tilla; se i pandehurit në kohën kur e ka kryer këtë vepër penale ka qenë i moshës relativisht të re, shprehjen e pendimit dhe keqardhjes së shfaqur nga i pandehuri, pajtimi në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit.

Gjykata, sa i përket dënimit me burg, në kuptim të nenit 66, të KPK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se ligji ka paraparë që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet dhe gjykata ka konstatuar se ekzistojnë rrethanë posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, pra në kuptim të nenit 66, par. 1, nën par.1 dhe 2, të KPK-së, për zbutjen e dënimit, respektivisht

që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 67, par. 1, nën par.2, të KPK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është se paku 5 vite, dënimi mund të zbutet deri në 3 vite, çka në rastin konkret Gjykata ka shqiptuar dënim për të pandehurin I.S. 3 (tre) vite burgim, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Qëllimi dënimit:

Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën është shpallë fajtor dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Llogaritja e paraburgimit:

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së qëndrimit në paraburgim të pandehurit u mor në pajtim me nenin 73 të KPK-së, ashtu që të pandehurit koha e kaluar në paraburgim nga data 06.11.2010 deri me datën 06.12.2010 do të llogaritet në dënimin me burgim të caktuar sipas këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale:

Gjykata ka vendosur që i pandehuri I.S. të obligohet që të paguajë shpenzimet e procedurës penale deri në lartësinë e shpenzimeve të shkaktuara të procedurës penale. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPRK-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe dëshmitarë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Vlerësimi i Gjykatës për pikën II, vepra penale: Ndhimë në Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 25 të KPK-së:

Lidhur me dispozitiv II të këtij aktgjykimi, Gjykata ka liruar nga akuza të pandehurin F.K. për veprën penale Ndhimë në Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 25 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25), ngase Gjykata ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se nuk është provuar se i pandehuri, në ditën kritike ka kryer veprën penale të Ndhimës në Vrasje të rëndë në tentativë, ngase me asnjë provë apo rrethanë tjetër faktike, Gjykata nuk ka gjetur se në veprimet te pandehurit F. janë përmbushur elementet e veprës penale të Ndhimës. Sipas nenit 25 të KPK-së i cili përcakton se *“Ndhimja për të kryer një vepër penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fshehë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale”* në veprimet e të pandehurit asnjë nga elementet e sipër theksuar nuk janë përmbushur, pra i pandehuri F., nuk e ka këshilluar e as udhëzuar të pandehurin I. se si të kryer vepra penale Vrasje e rëndë në tentativë, nuk i ka vënë në dispozicion asnjë lloj të mjetit me të cilin është kryer vepra penale, armën e ka deklaruar vet i pandehuri I. se e ka pas me veti dhe se është e tij. Këtë gjendje faktike Gjykata e ka vërtetuar edhe nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor si nga deklarata e dëshmitarit N. R. i cili ka deklaruar se i pandehuri F. fillimisht më ka goditur një herë në shpinë, tutje i pandehuri F. nuk ka ndërmarr veprime të tjera inkriminuese pasi që është goditur me mjet mbretes i njëjti ka mbet i shtrirë në dysheme derisa e ka tërhequr i pandehuri tjetër I.S., po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit M. Q. vërtetohet se i pandehuri F. vetëm e ka goditur nga prapa të dëmtuarin N. R., ndërsa veprime të tjera i pandehuri F. nuk ka ndërmarre.

Vlerësimi i mbrojtjes:

Lidhur me pretendime e mbrojtëses të pandehuri F.K., av. S. G., se, kjo aktakuzë nuk ka arritur provohet as pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor ndaj të mbrojturit tim për veprën penale për të cilën akuzohet. Mbrojtja thekson se me asnjë provë Prokuroria nuk ka arritur të dëshmoj se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, se nuk janë plotësuar asnjë nga elementet e veprës penale Ndhimja nga neni 25 i KPK-së. Nenin 25 të KPK ka paraparë që ndihma nënkupton ndihmën për të kryer një vepër penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryerësit mjetet për kryerjen

e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fshehë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale, andaj, Gjykatë cila nga këto elemente është plotësuar në rastin konkret tek i mbrojturi im. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, mbrojtja konsideron se Prokuroria nuk ka arritur që të argumentoj fajësinë e të mbrojturit tim, meqë pafajësia e tij prezumohet, nuk ka arritur në mënyrë të sigurt dhe të pakontestueshme ta argumentoj fajësinë e të akuzuarit.

Gjykata ka vlerësuar qëndrimet dhe pretendimet e mbrojtjes të pandehurit F.K. av. S. G., si reale dhe të vërteta, ngase nga gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata ka rezultuar si pandehuri F. nuk e ka kryer veprën penale Ndhimë në Vrasje të rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nën paragrafi 4 lidhur me nenin 25 të KPK-së, sepse nga provat që ka administruar si nga dëshmia e dëshmitarit N. R., i cili ka deklaruar se F. fillimisht me ka goditur nga prapa në shpinë e pastaj i dëmtuari është ngritur në këmbë dhe ka gjuajtur me shishe ku e ka goditur të pandehurin F. në mbi vetull të majtë dhe me atë rasti i pandehuri F. është rrëzuar në dysheme dhe nuk ka arritur që të kryej veprime të tjera pasi që tani ka ndërhyrë i pandehuri I. i cili ka shtënë me armë në drejtim të dëmtuarit N. të cilën e ka goditur në shpinë, e më pas të pandehurit I. dhe F. janë larguar në lokali, pra, këtu Gjykata nuk ka gjetur elemente të veprës penale të Ndhimës siç është parashikuar në nenin 25 të KPK-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit F.K. e dhënë ne Polici dhe Prokurori, i cili kishte deklaruar se ditën kritike rreth orës 17:00 kam qenë së bashku me I. S. në lokalin "A. C." në D., kemi hyrë dhe jemi ulur në një tavolinë afër banakut, në atë lokal kanë qenë ulur një tavolinë më larg vëllai i N. R., N., në ndërkohë e kam vërejtur se e ka thirr dikën në telefon dhe pas një kohe ka ardhur N. R., E. Sh. dhe një person nuk e njoh dhe janë ulur në një tavolinë afër neve. Derisa I. ka qenë duke fol në telefon jashtë lokalit, ka ardhur N. te tavolina ime dhe me ka thënë " a të kam thënë ti mos me dal në Dr. më" dhe kur është afruar afër tavolinës e ka nxjerr një thikë me dorezë dhe tek diku 20 cm, unë i thashë "ngadalë a mundemi me u marr veshë me fjalë" dhe ai më ka ra mbi vetullën e majtë dhe ka filluar të më rrjedhë gjaku dhe jam rrezuar në dysheme, menjëherë kam dëgjuar dy krisma të armës, krismën e parë nuk e vërejtur por në krismën e dytë ata më kanë lëshuar dhe unë e kam pa I. me armë në dorë, me ka kap për krahu me ka qit jashtë, pastaj më kanë dërguar në spital. Motivi i kësaj ngatërrese ka qenë se 3-4 ditë më herët N., E. dhe M., më kanë ndalur dhe më kanë thënë "mos të shohim më në D." por që

arsyen nuk e di. Nuk kemi pas ndonjë mosmarrëveshje të më hershme, tani jemi pajtuar me familjen e N.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit F. dhe pjesërisht të njëjtës ja ka falur besimin. Në pjesën e deklaramit ku thotë ka dëgjuar dy krizma të armës dhe se e ka parë I. me armë në dorë dhe pas të shtënave janë larguar nga lokali, është njëjtës ja ka falur besimin dhe është reale ngas gjene mbështetje edhe ne provat tjera materiale dhe personale si nga deklaratat e dëshmitareve dhe ekspertiza mjekoligjore dhe vërtetimi mi dorëzimin e armës nga i pandehuri I. Ndërsa pjesa tjetër e deklaratës për gjykatën nuk janë reale, për faktin se nuk gjejnë mbështetje ne provat tjera materiale.

Shpenzimet e procedurës penale:

Konform nenit 453 të KPPRK-së, derisa i pandehuri është liruar nga akuza, sa i për këtë shpenzimeve të procedurës penale bien barrë e mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

Kërkesën pasurore juridike:

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Gjykata, nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar ne nenin 364 te KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.306/2011, datë: 24.09.2024

Bashkëpunëtori profesional

Albrim Kastrati

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari

Gëzim ADEMI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.